

SYLLABUSI I LËNDËS – SOCIOLOGJI

Lënda:	Sociologji
Programi i studimit:	Studime Islame
Numri i ECTS kredive:	4
Statusi i lëndës:	Zgjedhore
Kodi i lëndës:	311
Fondi i orëve:	2+0
Viti akademik:	2026/2027
Semestri:	VI-të
Mësimdhënësi:	Prof. Ass. Dr. Ferdi Kamberi
Kontakti:	ferdikamberi04@gmail.com

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I LËNDËS

Ky kurs ofron një hyrje për problemet, çështjet, temat dhe idetë kryesore të Sociologjisë. Kursi, ka për qëllim të përcjellë faktet themelore sociale në shoqëri duke u mundësuar studentëve që të analizojnë një qasje shkencore për kuptimin dhe interpretimin e fenomeneve sociale dhe të zhvillojnë imagjinatën e tyre sociologjike mbi problemet e natyrës sociale, ekonomike, kulturore dhe politike.

QËLLIMI

Qëllimi i kursit është t'i japë studentit një pasqyrë të qartë të strukturave sociale, metodat e studimit të shoqërisë, dilemat teorike, disa praktika të rëndësishme të komunikimit dhe ndikimit të medias. Të menduarit sociologjikisht është gjithmonë kurioze rreth asaj përse njerëzit sillen në mënyra që ata sillen zakonisht? Andaj, ky kurs trajton më në thellësi sjelljet sociale të individit duke ofruar gjithmonë një shpjegim kritik dhe analitik mbi çështjet e shumta që hasim në shoqëri.

REZULTATET E PRITURA

Qëllimi i kursit është t'i japë studentit një pasqyrë të qartë të strukturave sociale, metodat e studimit të shoqërisë, dilemat teorike, disa praktika të rëndësishme të komunikimit dhe ndikimit të medias. Ndaj do të arrijnë këto rezultate:

- Studentët do të jenë në gjendje të aplikojnë konceptet themelore dhe format e analizës në Sociologji;
- Studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë, përshkruajnë dhe shpjegojnë aspektet kryesore të funksionimit të marrëdhënieve shoqërore;
- Të zhvillojnë të menduarit kritik lidhur me marrëdhëniet ndërmjet fenomeneve të ndryshme shoqërore;
- Të aplikojnë një qasje multi-disiplinare në interpretimin e çështjeve të ndryshme që ndodhin në shoqëri;
- Të njihen me metodologjinë empirike dhe të zhvillojnë shkathtësitë në përdorimin e teknikave të kërkimit empirik.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	3	5	15
Kontaktet me	2	5	10

mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren	-	-	
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	2	2	4
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	2	4
Përgatitja përfundimtare për provim	2	2	4
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet ,etj	2	2	4
Totali			100 orë / 4 ECTS

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

- Do të përdoret metodologji interaktive e mësimdhënies.
- Puna në grupe të vogla për të zgjidhur çështje të ndryshme pastaj diskutim i hapur në klasë.
- Ofrimi i mundësisë për prezantime me qëllim të zhvillimit të shkathtësisë së komunikimit dhe thellimit të njohurive.

VLERËSIMI

Vlerësimi do bëhet në sipas aktiviteteve të poshtëshënuara:

- Pjesëmarrja e rregullte = 5 %
- Aktiviteti në klasë = 5 %
- Punimi seminarik = 10 %
- Provimi përfundimtar = 80%

LITERATURA BAZË

1. Anthony Giddens. Sociologjia. Botues Toena, Tiranë 2005.
2. Thorpe, at al. Libri i Sociologjisë, Aedition, Tiranë, 2016.
3. Ligjërata të autorizuara nga pedagogu i lëndës.

LITERATURA SHITESË

1. Diana Kendall, Sociology in our times. Botues Princenton, New York, 2011.
2. John Macionis. Sociology. Botues PEARSON, Boston 2012.
3. Ali Dida: Fillet e sociologjisë ,Botues Enti i teksteve dhe mjeteve mësimore, Prishtine 1974

PLANI I DIZAJNUAR I MËSIMIT:

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java I	Prezantimi i syllabusit, qëllimi, synimet, rezultatet dhe literatura
Java II	Përkufizimi për sociologjinë, zhvillimi dhe themeluesit e

	sociologjisë
Java III	Agjenset e socializimit (familja, shkolla, grupmosha, komuniteti)
Java IV	Institucionet shoqërore (familja, martesë, divorci)
Java V	Identiteti dhe kultura
Java VI	Metodologjia e kërkimit shkencor
Java VII	Stratifikimi social
Java VIII	Krimi dhe devijimi
Java XIX	Politikat publike dhe aktorët qeverisës
Java X	Pushteti, partitë politike, nacionalizmi dhe lëvizjet shoqërore
Java XI	Religjioni
Java XII	Mediat dhe globalizmi
Java XIII	Mplakja e popullsisë dhe migrimet
Java XIV	Ndryshimet globale dhe mjedisi
Java XV	Përmbledhje e ligjëratave dhe përgatitje për provim
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Studentët janë të obliguar: • të respektojnë orarin e ligjëratave dhe të jenë të vëmendshëm në orën mësimore; • të iu përmbahen të gjitha rregullave edukativo-arsimore; • të jetë të përgatitur për ligjëratë duke qenë të pajisur me librin përkatës dhe fletoren për shënime; • që në respekt të kolegëve të tyre studentë t'i ndalojnë telefonat personal gjatë mësimi; • të jenë pjesëmarrës aktiv në ligjëratë; Studenti është i obliguar të paraqes dhe posedoj ID kartelën në kolokfiume dhe provime përfundimtare.	

Shënim:

Pjesëmarrja është parakusht për studentët që dëshirojnë të fitojnë njohuri të duhur të këtij subjekti. Studentët që ndjekin rregullisht kursin do të jetë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, duke dhënë kontributin e tyre konkret gjatë ligjëratave interaktive dhe gjatë ushtrimit. Kjo do të ndikojë që të pasurojnë dijen e tyre rreth modulit dhe të arrijnë rezultate më të mira.